



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL NR. 16
Rrogozhinë, më 31.12.2024 ora 12 : 00^{oo}

Zhvillohet mbledhja jashtë radhe e Këshillit Bashkiak, në sallën e mbledhjeve të Këshillit në katin e dytë pranë ish Bashkisë Rrogozhinë.

Rendi i ditës :

Në mbështetje të Njoftimit, të thirrur nga Zëvendëskryetari i Këshillit Bashkiak në grupin ehatsapp të Këshillit z. Erind Tosku, me rend dite si më poshtë :

- 1- Miratim i rendit të ditës.
- 2- Miratim i projekt - vendimit, “Për miratimin e Bursave të Nxënësve të Arsimit Parauniversitar”.

Marrin pjesë Këshilltarët prezentë në sallë :

Hekuran Xhani, Silvana Aliu, Indrit Dedej, Lije Dedej, Isa Halili, Sokol Gosa, Mitat Daja, Lorena Baku, Altin Tosku, Gezime Met-hasani, Lulzim Hasa, Alime Hoxha, Enver Memolla, Fatmira Thartori, Renato Klemi, Shpati Kolgega, Erind Tosku.

Mungojnë :

Besnike Coraj, Merilin Saraçi, Saimir Cani, Mukades Gixhari.

Të ftuar :

1. Edison Memolla - Kryetar i Bashkisë.
2. Andi Proshka - Nënkryetar i Bashkisë.
3. Rezart Vogli - Drejtor i Financës.
4. Orges Tosku - Drejtor i Arsimit, Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve.
5. Klea Dushku - Përgjegjëse e zyrës IT.
6. Sidorela Aliu - Specialiste e zyrës IT.



Drejtton mbledhjen :

Erind Tosku – Zëvendëskryetar i Këshillit.

Ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak : Këshilltarët e sipërcituar, si dhe specialistët e Bashkisë që janë thirrur për të shqyrtuar dhe relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulon secili prej tyre, sipas axhendës ditore.

- Pasi konfirmohet kuorumi i nevojshëm, gjithsej 12- Këshilltarë. Këshilltari z. Mitat Daja i bashkohet në vijim mbledhjes së Këshillit.

HAPET MBLEDHJA

Erind Tosku . Përshëndetje të nderuar Këshilltarë ! Meqë kemi kuorumin e nevojshëm për mbledhje jashtë radhe mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të hapur. Në këshill marrin pjesë 12 këshilltarë.

Pra kalojmë në miratimin e projektvendimit. Jeni dakord me rendin e ditës? Po të gjithë pro.

-Miratohet me 12 (dymbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) kundër, 0 (zero) abstenim, rendi i ditës së mbledhjes jashtë radhe datë 31.12.2024.

Erind Tosku . Miratim i projektvendimit “Për miratimin e bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar”. Relaton drejtori i arsimit Orges Tosku.

Orges Tosku . Atëherë përshëndetje të gjithëve ! Atëherë siç e lam dhe tek mbledhja tjetër këto janë bursa që akordohen nga ministria e arsimit për disa kategori nxënësish. Janë 32 emra, 20 do akordohen nga Ministria e Arsimit. 20 emrat e parë nga fondet e Ministrisë së Arsimit ndërsa pjesa tjetër nga fondet e bashkisë. Duke qenë se numri që ka sjellë Ministria e Arsimit ka qenë 20, aplikime kanë qenë 32 dhe mendojmë mos lejmë emra veç por të marrin të gjithë që kanë sjellë dokumentacionin.

Enver Memolla . Tani unë vazhdoj me propozimin që kisha në Janar me fondet e Bashkisë mund të shtojmë një listë tjetër që janë më AK?

Orges Tosku . Në bazë të këtij vendimi Bashkia ka gjithmonë të drejtë të akordojë bursa duke parë dhe pjesën financiare. Duhet me folur me drejtorin e financës...



Lulzim Hasa . A është i vlefshëm vendimi që miratohet në Janar pastaj?

Orges Tosku . Për sa i përket bursave që akordohen nga buxheti I bashkisë edhe në Janar... ndërsa për bursat nga Ministria e Arsimit dhe nga Ministria e Ekonomisë që kaluam në mbledhjen tjetër kanë afat deri në Dhjetor.

Alime Hoxha . Dosjet e nxënësve me AK janë tek zyra arsimore nëse është e nevojshme jua vë në dispozicion. Por dhe nëse nuk i akordojmë dot bursa të plota të gjithëve të shohim mundësinë...

Enver Memolla . Hidhe në votim.

Silvana Aliu . Çfarë masash do merret se edhe një listë që kaluam vitin që kaloi, akoma janë pa marrë likuidimin?

Orges Tosku . Ne i kemi dërguar shkresa Ministrisë dhe do i dërgojmë sërish, se normalisht siç e thamë këto janë fonde që i sjell Ministria e Arsimit, Ministria e Ekonomisë nuk ka pasur probleme, i kanë kaluar profesionalet ndërsa këto akoma.

Alime Hoxha . Kanë qenë nga Ministria apo ka dhe pjesë nga Bashkia?

Orges Tosku . Ka dhe nga Bashkia.

Alime Hoxha . As ato nuk janë kaluar?

Orges Tosku . Jo. Kemi menduar t'i kalojmë të gjithë, jo ky i mori ky si mori.

Erind Tosku . Mbledhjes ju bashkua z. Mitat Daja. Atëherë ndonjë pyetje tjetër? E hedhim në votim rendin e ditës për pikën e parë për këtë çështje, e hedhim në votim këshilltarë. Të gjithë pro. Miratohet.

-Miratohet me 13 (trembëdhjetë) vota pro, 0 (zero) vota kundër, 0 (zero) vota abstenim, projektvendimi "Për miratimin e Bursave të Arsimit Parauniversitar".

Vendim nr.71. Miratohet me 13-vota pro, projektvendimi i propozuar nga Kryetari i Bashkisë me Nr.5307. Prot datë 24.12.2024 "Për miratimin e bursave të arsimit parauniversitar" si dhe relacion shpjegues me nr.5307/1. Prot datë 24.12.2024.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK**

Erind Tosku . Meqë nuk kemi diskutime të tjera mbledhjen e deklaroj të mbyllur. Po z. Enver.

Enver Memolla . Duke qenë se është dita e fundit e vitit, ju uroj të gjithëve gëzuar dhe një vit të mbarë dhe mbarësi për vitin tjetër.

Hekuran Xhani . Qoftë një vit i mbarë për ju dhe familjet e juaja, mbarësi dhe begati paçit.

Erind Tosku . Gëzuar të gjithëve dhe faleminderit.

MBYLLET MBLEDHJA

- Mbledhja deklarohet e mbyllur zyrtarisht rreth orës 12 : 10^{oo} . Video regjistrimi i kësaj mbledhjeje zgjati rreth 04 min ; 23 sek.
- Ky procesverbal mbyllet në faqen 4 (katër).

Miratohet procesverbali :

Zbardhi (transkriptoi) procesverbalin :
Sekretari i Këshillit
Ervis Shera